



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1410 Prot.

Tiranë, më 11.11 2019

VENDIM Nr. 241, datë 08.11.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13, datë 08.11.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Hidrocentralit Faqekuq 3, Bashkia Çorovodë"*-subjekti "MER ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Hidrocentralit Faqekuq 3, Bashkia Çorovodë"*-subjekti "MER ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj.
2. Subjekti "MER ENERGJI" sh.p.k, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin *"Ndërtimi i Hidrocentralit Faqekuq 3, Bashkia Çorovodë"*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**